

Leksioni 8

SINTAKSA E PERIUDHËS

1. PERIUDHA SI NJËSI SINTAKSORE

Në traditën tonë gramatikore, për këtë njësi sintaksore janë përdorur terma të ndryshëm, si: periudhë, periodë, frazë dhe në mjaft tekste mësimore të arsimit 9-vjeçar e të mesëm, fjali e përbërë. Por çështja e termit nuk e ndërron përmbajtjen e saj. Gjatë ligjërimit apo komunikimit tonë të përditshëm me të tjerët, ne nuk përdorim vetëm fjali, për të cilat kemi thënë se kanë një *bërthamë kallëzuesore*, por na duhen edhe ndërtime të tilla, më të gjera, që përmbajnë dy ose më tepër bërthama kallëzuesore.

Për shembull:

Fjala e dhënë duhet mbajtur,

është fjali, sepse ka një bërthamë kallëzuesore, të shprehur këtu me anë të një foljeje; kurse ndërtimet që pasojnë:

Fjala që i jepet dikujt duhet mbajtur,

apo

Fjala që i jepet dikujt, sido që të ndodhë, duhet mbajtur;

janë periudha, sepse formohen respektivisht nga 2 dhe 3 bërthama kallëzuesore. Rreth këtyre bërthamave sillen elementet e tjera që i formësojnë ato, duke formuar një njësi të vetme kumtuese, intonacionore dhe sintaksore. Njësitë kallëzuesore që i formësojnë fjalitë e përbëra quhen pjesë të fjalisë.

Midis fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë nuk ka ndryshime kuptimore, por vetëm ndryshime strukturore.

Pra, siç mund të keni parë edhe nga shembujt e këtij teksti, periudhat formësohen prej fjalish, për shembull:

Bota është e re dhe ka shumë gjëra për të zbuluar.

(2 fjali)

Ai shikonte doktorin, sepse ai ishte pasqyra e së vërtetës që nuk e dinte.

(3 fjali)

Barku i njeriut është i mbushur me mikrobe të vogla, të cilat janë si insektet, por syri nuk i dallon, sepse ato janë të padukshme.

(4 fjali)

Modeli më i thjeshtë i periudhës është ai që përmban dy fjali, bie fjala :

Derën e huej e lëvdosh, por mbrendë mos i shkosh.

Hinë e vatrës të lëpish dhe mos dëshirosh fëmijët në dhe të huaj.

Në të gjithë këta shembuj të fundit ka dy bërthama kallëzuesore, kështu që përkufizimi do të ishte si vijon:

***PERIUDHA ËSHTË NJËSI SINTAKSORE NDËRTIMORE, KUPTIMORE
DHE INTONACIONORE QË KA MË TEPËR SE NJË BËRTHAMË
KALLËZUESORE.***

Për shembull:

Kur hyn sorra në trëndafil, i duket vetja bilbil.

Mos ia hiq petën lakrorit, se i duken lakrat.

Rakia nuk rri urtë në bark, ashtu siç rri në shishe.

Në këto ndërtime unitetin kuptimor, gramatikor dhe intonacionor e mban tërë periudha, jo përbërësit e saj veç e veç.

Periudha të tilla kanë një vijë intonacioni që ngrihet deri në fund të njëres fjali dhe nis e bie deri në mbarim të tjetrës.

Përbërësit e periudhës, më të shumtën e herës, nuk kanë kuptim dhe pavarësi të plotë si fjalitë e mëvetësishme, por hyjnë në raporte e marrëdhënie me njëra-tjetrën, më tepër, me anë të mjeteve që shërbejnë për t'i bashkuar ato në periudhë.

2. Mjetet e lidhjes sintaksore të përbërësve në periudhë

Mjetet gjuhësore që shërbejnë për të lidhur përbërësit e periudhës, duke formuar fjalinë e përbërë janë :

1. **Lidhëzat** – që në gjuhën shqipe ndahen në *lidhëza bashkërenditëse* dhe *lidhëza nënrenditëse*, duke përcaktuar kështu marrëdhëniet me bashkërenditje dhe nënrenditje në periudhë.

Një pjesë e këtyre lidhëzave kanë një vlerë më të përgjithshme, kurse të tjerat një vlerë më të specializuar.

Për shembull:

*U dogj plaka kungujsh **dhe** i fryn kosit.*

Shit kalin e mëso djalin.

*E bukur është bora, **po** e ndotin qentë.*

*Mehmeti nga Permeti si kërkoi, **ashtu** gjeti. Lumenjtë, **kudo që** venë, në det derdhen.*

***Po** nuk erdhi pranvera, s'këndon qyqja.*

***Kur** të thonë ngordhi ujku, ruaj dhentë.*

2. **Fjalët lidhëse** – quhen kështu disa përemra lidhorë (*që, i cili, kush* etj.) e ndajfolje lidhore (*ku, nga, kur*), të cilët shërbejnë për të lidhur përbërësit kallëzuesorë të periudhës, duke plotësuar njëkohësisht edhe një funksion sintaksor, bie fjala :

***Kush** madhohet, rrëzohet.*

***Kush** ka matur veten, ka matur gjithë botën.*

*Mos beso **çka** thotë ylberi, kqyr se të kallzon defteri. Puno **ku** të thonë.*

*Në një shtëpi **që** nuk ka mace, hedhin valle minjtë.*

Fjalët lidhëse përdoren në fjalinë e varur (e ashtuquajtura “*lidhje përmendëse*”), kurse përemrat dëftorë dhe ndajfoljet dëftore, që quhen edhe fjalë të bashkëlidhura (fjalë korrelative ose korrelatë) përdoren brenda fjalisë kryesore, në bashkëlidhje me lidhëzat e fjalët lidhëse.

3. **Intonacioni** – është një mjet fonetik e sintaksor, që shërben edhe për segmentimin e bashkimin e përbërësve të periudhës, ashtu edhe për të shprehur e ruajtur unitetin e periudhës në tërësi, duke shprehur marrëdhënie të ndryshme kuptimore e sintaksore me anë të elementeve të tij, si: *pauzat, ritmi, toni dhe melodika*. Roli i intonacionit del në pah sidomos në periudhat me fjali *jolidhëzore* (asindete), fjala vjen:

Dajë Meta shikon punët e veta, // dajë Kasa çan dërrasa.

Më rrejte një herë, // të vraftë Zoti ty; më rrejte dy herë, // më vraftë Zoti mue.

Në të dy çiftet e periudhave më sipër, sipas qëllimit të thënies, ka marrëdhënie kushtore, kohore e shkakore.

E mira s'ka tavan, // e keqja s'ka taban.

Sytë e larguar, // zemër e harruar.

Si prifti me priftëreshën, // si hoxha me hoxheshën.

Si Hasa – kasa, si thesi- trasta. etj.

4. **Fjalët korrelative** - janë :

- përemrat dëftorë (*ky, kjo, ai, i tillë* etj.);
- ndajfolje që marrin shkallë të ndryshme dhe që nuk marrin shkallë (*këtu, aty, andej, tani, ashtu, aq, kaq* etj.);
- mbiemra të ndryshëm në krahasore e sipërore (*kaq i bukur, aq i shpejtë* etj.);
- disa togje fjalësh, si: *në atë pikë, në atë nivel, në atë shkallë, në atë gradë, në atë masë* etj., që shprehin kuptime të përgjithshme, përmbajtja e të cilave shtjellohet në fjalinë vijuese.

Për shembull :

Ky fshat është i tillë që mund të rrojë me turizëm.

*Zjarret iu afruan aq shumë Athinës, sa u rrezikua edhe Akropoli.
Atleti xhamaikan ishte aq i shpejtë, sa të gjithë e krahasojnë me erën.
Puna arriti në atë gradë, sa që marrëdhëniet e tyre u ftohen krejt.
Merr ato që të duhen.
Merri të gjitha sa duhen.*

5. Rendi i fjalive përbërëse të periudhës - mund të jetë *rend i lirë* ose *rend i ngulitur* dhe bëhet mjet i lidhjes sintaksore, duke u shfaqur :

- rend me paravendosje, p.sh.:

Kur hyri mësuesi në klasë, nxënësit u ngritën në këmbë.

- rend me ndërvendosje, p.sh.:

Nxënësit, kur hyri mësuesi në klasë, u ngritën në këmbë.

- rend me prapavendosje, p.sh.:

Nxënësit u ngritën në këmbë, kur hyri mësuesi në klasë.

6. Bashkërregullimi i trajtave mënyrore dhe kohore të foljeve-kallëzues – është dukuri morfosintaksore që ndihmon në lidhjen e njësive përbërëse të periudhës, midis foljeve të fjalive të varura dhe atyre drejtuese, si, bie fjala:

*Çdo ditë lexoj disa faqe letërsi, kurse ti pikturon tablo të ndryshme.
(njëkohësisht në të tashmen)*

Kur u afrove tek unë, se ç' ndjeva një forcë në shpirt. (njëkohësisht në të shkuarën).

Do të ruaj kujtime të paharruara për atë vend, kurse ti do t'i shkruash ato në formë ditari. (njëkohësisht në të ardhmen).

USHTRIME

Ushtrimi 1. *Lexoni tekstin dhe dalloni ndërtimet që janë fjali dhe ato që përbëjnë një periudhë.*

Një pasanik kishte dëshirë të bënte një tavan të bukur prej druri. Atëherë ai thirri një mjeshtër të gdhendjes në dru dhe i tha: *“Ti do të më bësh një tavan, që, kush ta shohë, të çuditet. A mund të ma bësh?”* Mjeshtri e pa odën, e mati me sy tavanin dhe u përgjigj: *“Ta bëj! Dhe të gjithë ata që do ta shohin, do të çuditen”*. Mjeshtri iu përvesh punës dhe gdhendi në tavan lloj-lloj zogjsh e lulësh, kafshësh e pemësh. Punoj dy a tre vjet të tërë, siç tregojnë. Dukej sikur u dha shpirt edhe zogjve, edhe kafshëve, edhe luleve, edhe pemëve. Kur e mbaroi tha: *“Më e bukur nuk mund të bëhet. As mjeshtrit e huaj më të bukur nuk e bëjnë dot. Vetëm unë mund ta bëj më të bukur!”*

(D. Agolli, Trëndafili në gotë, Vepra letrare 8, T. 1981, fq. 204-205)

Ushtrimi 2: *Lexoni tekstin dhe dalloni mjetet e lidhjes sintaksore, duke i analizuar periudhat me më shumë se dy fjali:*

Në mbrëmje, kur hoxha falej nga xhamia dhe foletë e lejlekëve dukeshin si ca çallma të zeza, të rrasura majë oxhakëve dhe minareve, ne vërtiteshim rreth portës së shtëpisë së Nazos, për të parë nusen e porsamartuar. Ajo dilte e rrinte në sofatin e gurtë bashkë me Nazon, duke trazuar me gishta gërshetin e trashë, ndërsa në sytë i ndizej herë pas here një dritë e çuditshme, e magjishme. Asnjëherë s’kishte ardhur nuse kaq e bukur në lagjen tonë. Ne, të vegjlit, e thërrisnim midis nesh *“Nusja e bukur”* dhe na pëlqente që ajo të na shikonte kur vraponim përpara portës së madhe të Nazos, duke ndjekur xixëllonjat ose lakuriqët e natës në muzg. Ajo rrinte e menduar, na vështronte me sytë e mëdhenj e të bukur gri dhe dukej që e kishte mendjen diku gjetkë. Pastaj, vinte dhëndëri nga pazari ose nga kafeneja, duke mbajtur në sjetull një pjepër, a një çyrek dhe nusja bashkë me vjehrrën çoheshin

nga sofati në heshtje dhe futeshin brenda, ndërsa ai mbyllte portën e rëndë, që kërciste vajtueshëm.

(I. Kadare, Kronikë në gur, T. 1967, fq. 22-23)

Ushtrimi 3. *Kufizoni marrëdhëniet e bashkërenditura dhe të nënrenditura, duke treguar edhe mjetet e lidhjes sintaksore:*

Kallxon desidiati: Batua u mbush me pezm dhe, pa një pa dy, i ngriti pusi Batos së breukëve, e mundi në një luftë të përgjakshme; Batua i breukëve, tue kërkue birën e minit, shkoi e t'u mbyll në një kështjellë; Batua e rrethoi kështjellën dhe, tue ba be përmbi be, kërkoi t'ja qesin jashtë Baton e breukëve, dhe ata të kështjellës ja qitën jashtë Baton e breukëve, Bato i breukëve ra në duer të Batos, Bato e nxori Baton e breukëve para ushtarëve, Bato i breukëve tash dridhej, tash i dridheshin kambet para Batos, dikur Batos së breukëve i shpërthyen lotët, ja plasi edhe vajit, por Batua e bani zemrën gur, nuk i dha pesë pare për lotët e Batos së breukëve, për vajin e Batos së breukëve, por vetëm i tha, Bato i tha Batos së breukëve se pasqyrat me dy faqe, se shumë pasqyrat me dy faqe që ka marrë nga Tiberi, pasqyrat me dy faqe që po shtohen ndër breukë i ka marrë për të thye qerren e diellit, e diellit, dhe për të ra muga, muga, dhe Bato i desidiatëve e vrau Baton e breukëve, mandej qerrja e diellit e shkeli Baton e breukëve, mandej Bato me ushtarët e vet e lanë Baton e breukëve, të vramë e të shkelun prej qerres së diellit, mandej fryni era dhe erdhën derrat e egër, të cilët i trembi Tiberi, erdhën derrat e egër dhe e shkafjuen Baton e breukëve, i morën copat e Batos së breukëve, i shpërndanë kahmos, dhe kahmos u ngulën eshtnat e Batos së breukëve, kahmos u ngulën, andej e këndej,...

(A. Pashku, "Oh", Shkodër, 2002, fq. 40-41)

(B.

Detyrë në shtëpi: Nga një libër letërsie gjeni një tekst të shkurtër ku të ketë fjali e periudha; nënvizoni kallëzuesit, i ndani fjalitë përbërëse me një vijë dhe shënoni në kllapa sa përbërës - fjali kanë.